



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 8.5.2023

Nr: 464

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**KRIJIMIN E KQV-SË SË POSAÇME DHE SASINË E FLETËVE TË VOTIMIT PËR QENDRËN E POSAÇME TË VOTIMIT NR. 4383/01, KZAZ 79, BASHKIA TEPELENË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenit 43, nenit 62, pika 2, nenit 93, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 79, Bashkia Tepelenë, me shkresën nr. 4474 prot., datë 02.05.2023, ‘Kërkohe ngritja e KQV-së së posaçme’, i propozon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, krijimin e Komisionit të Qendrës së Posaçme të Votimit nr. 4383/01, Njësia Administrative Qendër, Tepelenë.

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është administruar vendimi nr. 01, datë 27.04.2023, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër “Kërkesë për dhënien e të drejtës për të votuar personave të paraburgosur dhe të dënuar, që ndodhen aktualisht në I EVP Tepelenë, të cilët kanë të drejtë vote po nuk figurojnë në listën përfundimtare të zgjedhësve”, të QV 4383/01.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve duhet të autorizojë KZAZ nr. 79, Bashkia Tepelenë, që të krijojë komisionin e kësaj qendre votimi dhe të marrë masat për të siguruar fletët e votimit të QV nr. 4383/01, nga qendrat e tjera të votimit të KZAZ nr. 79, me procesverbale.

Data: 8.5.2023 Nr: 464  
Ora: 12:00



“Për krijimin e KQV-së së posaçme dhe sasinë e fletëve të votimit për qendrën e posaçme të votimit nr. 4383/01, në KZAZ nr. 79, Bashkia Tepelenë për zgjedhjet e dates 14 maj 2023”

## PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 43, nenin 62, pika 2, nenin 93, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

### V E N D O S:

1. Autorizimin e KZAZ nr. 79, Bashkia Tepelenë që me vendim të krijojë dhe emërojë Komisionin e Qendrës së Posaçme të Votimit nr. 4383/01.
2. Autorizimin e KZAZ nr. 79, Bashkia Tepelenë të marrë nga 22 (njëzet e dy) fletë votimi për kryetar dhe nga 22 (njëzet e dy) fletë votimi për këshill nga QV nr. 4391/00, QV nr. 4391/01, QV nr. 4392/00, QV nr. 4394/00, QV nr. 4395/00.
3. KZAZ nr. 79 të marrë masat që QV nr. 4383/01, të pajiset me fletët e votimit nga QV-të e cituara në pikën 2.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të KQZ-së.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**